# AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE

## RAPORTI I PANELEVE TË EKSPERTËVE MBI VALIDIMIN E KUALIFIKIMIT

### PJESA 1:
### PËRMBLEDHJA DHE REKOMANDIMET

**DETAJE RRETH KUALIFIKIMIT TË VALIDUAR NGA PANELI:**

**Titulli i kualifikimit**

**Teknologji Informative dhe e komunikimit**

**Niveli i Kualifikimit në KKK**

| | |
|---|---|
| KKK Niveli 5 | √ |
| KK Niveli 4 | |
| KK Niveli 3 | |
| KKK Niveli 2 | |
| KKK Niveli 1 | |

**Lloji i Kualifikimit**

| | |
|---|---|
| Kualifikimi i bazuar në shkollë i kombinuar Arsim i përgjithshëm dhe Profesional | |
| Kualifikimi në Aftësimin Profesional bazuar në Standardet Profesionale Kombëtare | √ |
| Kualifikimi në Aftësimin Profesional jo i bazuar në Standardet Profesionale | |
| Tjetër (specifikoni) | |

**Vlera e kredive të Kualifikimit**

| | |
|---|---|
| **Nr. i Kredive** (1 Kredit = 10 orë joreale) | 22 |

**Numri tipik i orëve të nevojshme mësimore**

| | |
|---|---|
| Mësimnxënie e udhëzuar (Contact) Orët | |
| Orë teorike të përgjithshme | |
| Orë teorike profesionale | 50 |
| Praktike | 100 |
| Vlerësimi | 20 |
| Vetë-studimi | 53 |

**EMRI I INSTITUCIONIT I CILI APLIKON: QENDRA E TRAINIMIT -KEK NË KOSOVË**

**EMRAT E ANËTARËVE TË PANELEVE TË EKSPERTËVE TË CILËT KANË MARRË PJESË NË VLERËSIM:**

**RAMADAN DERVISHI**- EKSPERT – KRYESUES I PANELIT

**RAMË LIKA**, EKSPERT - ANËTAR I PANELIT

**KALTRINA MULLIQI**- EKSPERT PËR SIGURIMIN E CILËSISË- AKK

**DATAT E TAKIMEVE TË VLERËSIMIT:**

Vizita e panelit në QT KEK: **13/11/2012**

Hartimi i raportit: **20/11/2012**

**REKOMANDIMET TEK BORDI I AKK:**

| | |
|---|---|
| **Aprovohet vetëm si qendër e aftësimit profesional** | √ |
| **Mos aprovim** | |

**Nëse rekomandohet aprovimi, ju lutem të ofroni detaje lidhur me kushtet të cilat duhet të plotësohen:**

| Kushtet (nëse ka ndonjë): | Afati i fundit: |
|---|---|
| 1. Programi i zbatuar për trajnimin e ECDL ka si përmbajtje sistemin operativ Windows XP dhe Microsoft Office 2003. Rekomandohet që të bëhet përditësim i programit, në mënyrë që kandidatëve të mund të ju ofrohet trajnimi për versionet e fundit të sistemit operativ dhe paketës së Office-it. | 01.07.2013 |
| 2. Rekomandohet që të krijohet një plan i trainimit dhe certifikimit të | 01.07.2013 |

| trainereve me programet më te reja që ofron kjo qendër (Office 2010) | |
|---|---|

**Rekomandimi është akorduar nga Paneli mbi:**

**Nënshkruar:**

**…………………………………**
**(Kryesuesi i Panelit)**

**PJESA 2:**
**REZULTATET E PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMET**

**VËZHGIMET E PËRGJITHSHME MBI KUALIFIKIMIN E VALIDUAR DHE/OSE INSTITUCIONIN I CILI APLIKON**

**Verifikimi i të dhënave dhe aplikacioneve;**

Paneli gjatë leximit të dokumentacionit ka vlerësuar se përpilimi/plotësimi i formularit për validim të kualifikimit "Teknologji Informative dhe e komunikimit" ka informacione të mjaftueshme.. Menaxhmenti, koordinatori i sigurimit të cilësisë dhe i tërë stafi i qendres së trainimit KEK-së ishin bashkëpunues gjatë gjithë kohës së vizitës.

**Struktura e kualifikimit dhe modulet; Dokumentet dhe materialet që shfrytëzohen për trajnim;**

Kualifikimi është i bazuar në një strukturë modulare e cila është standardizuar sipas standardit profesional për Teknologji Informative ECDL dhe është e ndarë në 7 module dhe përkon me nevojat e tregut të punës. Megjithatë preferohet që këto module të kalojnë në versione të reja.

**Dëshmitë për vlerësim, certifikim, testet;**

Panelit i janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për testin hyrës, testet modulare dhe për testin përfundimtar. Në testin hyrës identifikohen njohuritë paraprake të kandidatit dhe në bazë të kësaj dihet se cili është niveli i kandidatit dhe në cilat pjesë/module duhet kushtuar më shumë rendësi. Të gjitha vlerësimet si ato teorike ashtu edhe ato praktike ruhen dhe janë pjesë e portofolit të kandidatit.

**Të dhënat për portfoliot e kandidatëve dhe stafi trajnues**

Paneli ka parë disa portfolio të kandidatëve të cilat kanë dëshmuar për të dhënat e testeve, projekteve, dhe të dhënave tjera.

Trajnerët janë të kualifikuar, por preferohet që dija e tij të përditësohet dhe të certifikohet për versionet e reja të ECDL-it.

**<u>Kualifikimi për: TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE KOMUNIKIMIT</u>**

Paneli vlerëson se QT KEK posedon nëpunës te kualifikuar për lëmine e teknologjisë informative, njëkohësisht preferohet që njohuritë të përditësohen. Paneli në bazë të Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare dhe në bazë të gjendjes së qendrës rekomandon validimin dhe akreditimin për **nivelin II të KKK**. Ky rekomandim bazohet në numrin e orëve dhe tek shkathtësitë individuale të fituara nga ana e kandidatëve. Po ashtu bazohet edhe në standardet e njohura ndërkombëtare (ECDL, Syllabusi 5.0; ECDL BCS Qualifications dhe Scotland IT User Qualifications Portfolio) dhe përshkuesit e niveleve të KKK.

**KOMENTET (NËSE KA NDONJË) LIDHUR ME CILËSINË E INFORMATAVE/DOKUMENTEVE TË PARASHTRUARA ME APLIKACION**

Drejtori, menaxhmenti dhe i gjithë stafi tjetër i qendrës kanë treguar gatishmëri të lartë në ofrimin e të

gjitha informacioneve të kërkuar nga ana e panelit.

**ÇËSHTJET ME INTERES (NËSE KA NDONJË) – DUKE PËRFSHIRË ARSYESHMËRINË PËR ÇDO KUSHT TË PROPOZUAR NGA PANELI**

Paneli ka konstatuar se qendra trajnuese duhet të dergojë trajnerët në përditesimin e njohurive të tyre duke u bazuar në versionet më të reja të paketës mësimore.

## PJESA 3: VLERËSIMI I KUALIFIKIMIT KUNDREJT KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË VALIDIMIT TË CILAT ZBATOHEN PËR TË GJITHA KUALIFIKIMET

**1. KUALIFIKIMI I CILI PROPOZOHET PËR VALIDIM DUHET TË JUSTIFIKOHET.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Kualifikimi për Teknologji Informative deri me tani ka qenë i koordinuar sa i përket standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Plan programi dhe paketa mësimore është standardizuar sipas standardit ndërkombëtar dhe ajo përmban 7 module sipas standardit profesional për Teknologji Informative dhe ka objektiva dhe rezultate të pritshme. Ky plan program përmban edhe të gjitha format e vlerësimit të cilat i kërkon standardi profesional. Megjithatë mund të bëhet më shumë tek pjesa e hapësirës dhe e laboratorëve dhe tek përditësimi i versioneve duke kaluar në versione me të reja.

**2. KUALIFIKIMI OSE MODULI KA NJË ARSYETIM TË QARTË E CILA BËN QË SYNIMET, OBJEKTIVAT, MUNDËSITË PËR PROGRES DHE MBËSHTETJA NGA GRUPET KYÇE TË INTERESIT TË JENË TRANSPARENTE.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Qëllimi i këtij kualifikimi është inkuadrimi në tregun e punës dhe ka objektiva të qarta, por ka mundësi për një progres më të madh. Analizat rreth arsyetimeve, synimeve dhe objektivave kryesisht bëhen nga organizata dhe donatorët e ndryshëm. Nuk ka mekanizëm të saktë të matjes se apo arrihet objektivi e kryesor që kandidatët e certifikuar të mund të kapen në tregun e punës dhe të gjejnë punë apo edhe ata që janë të punësuar të mund të avancohen në punët e përditshme që kryejnë .

**3. KUALIFIKIMET PROFESIONALE DUHET TË KENË MBËSHTETJE BRENDA SEKTORIT PËRKATËS.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | √ |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Kualifikimet profesionale janë në një nivel të kënaqshëm, por ka vend për përmirësime sidomos në trajnime shtesë për të përditësuar njohuritë e fituara më herët. Me qëllim që trajnerët brenda sektorit të jenë sa me profesional duhet që të ndjekin trajnime/seminare të ndryshme ku do të njoftoheshin me të rejat nga fushat e tyre dhe me pas këto njohuri do të mund të i përcillnin tek kandidatët.

**4. KUALIFIKIMI DUHET TË KETË SPECIFIKIM TË QARTË TË PËRMBAJTJES DHE PJESËVE TË OBLIGUESHME, ZGJEDHORE APO OPCIONALE.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | √ |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Kualifikimi i teknologjisë informative është i qartë sa i përket standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe është në formë modulare. Specifikohen saktë dhe qartë pjesët obligative dhe pjesët zgjedhore të secilit modul.

**5. KUR ËSHTË E MUNDUR, DUHET TË TREGOHET NUMRI I ORËVE MËSIMORE/TRAJNIMIT, TË NEVOJSHME PËR ARRITJEN E KUALIFIKIMIT.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Për arritjen e nivelit kualifikimit të propozuar për Teknologji Informative janë të nevojshme gjithsej

| | | |
|---|---|---|
| Kryesisht plotësohet | √ | 223 orë (, orë praktike 100, vlerësimi: 20, vetë studimi: 53, orë teorike të profesionale: 50), pra 22 kredi (1 kredi=10orë). Paneli konstaton se numri i orëve dhe kredive kryesisht plotësohet.. |
| Përmbushet plotësisht | | |

**6. NIVELI I KUALIFIKIMIT DHE VLERA E KREDISË SË MODULEVE TË CILAT PËRFSHIHEN NË TË, JANË TË PËRCAKTUARA NË MËNYRË TË SAKTË (SHIH SHTOJCËN B PËR UDHËZIME MBI NIVELET E KUALIFIKIMIT).**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Niveli i kualifikimit dhe vlerat e orëve dhe kredive për secilin modul të përfshirë në përmbajtjen e trajnimit për Teknologji informative janë të përcaktuara në mënyrë të saktë.

**7. KËRKESAT HYRËSE, PËR NJË KUALIFIKIM APO NJOHURI PARAPRAKE, ARRITJET OSE PËRVOJA, JANË TË QARTA.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | √ |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Qendra e Trainimit KEK ne pajtim me Ligjin e Punës te R. Se Kosovës, ka definuar standardin e saj te moshës se pjesëmarrësve. Kërkesat hyrëse për kualifikimin dhe njohuritë paraprake janë të qarta ku specifikohet se kandidatët duhet të jenë mbi moshën 18 vjeçare dhe nën moshën 60 vjeçare.

**8. NUK DO TË JETË OBJEKT I DISKRIMINIMEVE TË DREJTPËRDREJTA APO TË TËRTHORTA APO PENGESAVE NË QASJE.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Në bazë të vizitës së bërë nuk është vërejtur ndonjë diskriminim i asnjë natyre. Në bazë të dokumentacionit të ofruar dhe intervistave të zhvilluara nga paneli me përfaqësuesit e qendrës si dhe kandidatët del se qendra promovon qasje të barabartë dhe pa diskriminim për të gjithë kandidatët.

**9. METODAT E VLERËSIMIT DUHET TË JENË: TË DREJTA DHE OBJEKTIVE; FLEKSIBILE; VALIDE; TË BESUESHME; TRANSPARENTE; PRAKTIKE DHE ME SHPENZIME TË ARSYESHME.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | √ |

**Arsyet për këtë konkluzion:**
Metodat e vlerësimit që aplikohen janë:

- Testi hyrës
- Testet modulare
- Vlerësimi përfundimtar

Në bazë të informacioneve të mbledhura nga kandidatët, shihet se vlerësimi është korrekt dhe i paanshëm.

**10. KUR ËSHTË E MUNDUR, PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT PËRFSHINË TREGUES APO KRITERE PËR VLERËSIM, KRITERET E TILLA DUHET TË SIGUROJNË BAZË TË VLEFSHME DHE OBJEKTIVE PËR TË DALLUAR PUNËN NË VLERËSIMIN E KANDIDATËVE TË NDRYSHËM.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Përshkrimi i kualifikimit përfshin kriteret për vlerësim të cilat gjatë procedurës së vlerësimit të kandidatëve sigurojnë që të arrihen objektivat e synuara për secilin modul. Meqë programi i trajnimit te ECDL-se i ka te standardizuara testet e moduleve e se bashku me te edhe metriken e kalueshmërisë e shprehur ne përqindje, atëherë pragu i kalueshmërisë është 75%

**11. KUALIFIKIMI I HARTUAR DUHET TË KETË CILËSI TEKNIKE DHE KONTROLL RIGOROZE TË SIGURIMIT TË CILËSISË.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht | √ |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Në bazë të analizës së përgjithshme të paketës mësimore, testeve për vlerësim dhe detyrave praktike është konkluduar se cilësia është në nivelin e kënaqshëm. Vlen te theksohet se menaxhmenti i QT KEK është shume aktiv ne përmirësimin e cilësisë te trajnimeve te ofruara. Kështu, ai ka përgatitur pyetësorin që vlerëson përformancën e trajnerit dhe procesit mësimor të

| | |
|---|---|
| plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

qendrës nga ana e kandidatëve. Në bazë të këtyre pyetësorëve menaxheri e bënë edhe vlerësimin e stafit gjegjësisht, performancës së stafit në baza vjetore.

**12. SISTEMI I DOKUMENTIMIT PËR KUALIFIKIME DUHET TË JETË I PËRSHTATSHËM DHE TË PËRFSHIN DËSHMI TË MJAFTUESHME PËR VERIFIKIMIN E TË ARRITURAVE INDIVIDUALE TË KANDIDATËVE.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | √ |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Në bazë të dëshmive të ofruara nga QT KEK, dhe në bazë të intervistave të zhvilluara në qendër është parë se ka dokumente të mjaftueshme për të verifikuar të arriturat e kandidatëve për kualifikimin. Secili kandidat ka portfolion ku është i sistemuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që nga fillimi i trajnimit deri në përfundim.

## PJESA A:
## KUALIFIKIMET E BAZUARA NË SHKOLLË TË CILAT KOMBINOJNË ARSIMIN PROFESIONAL DHE ATË TË PËRGJITHSHËM

### VLERËSIMI I KUALIFIKIMIT KUNDREJT KRITEREVE SPECIFIKE TË VALIDIMIT

**1. KUALIFIKIMI OSE MODULI ËSHTË I KRAHASUESHËM ME KUALIFIKIMET OSE MODULET E ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM NË TË NJEJTIN NIVEL, PËRFSHIRË PËRMBAJTJET ME ARSIMIN E PËRGJITHSHËM, KOMPLEKSITET DHE NIVEL TË VËSHTIRËSISË TË PËRMBAJTJES PROFESIONALE.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

**2. KUALIFIKIMI OSE MODULI PËR TË CILIN NUK KA STANDARDE KOMBËTARE DUHET TË ZHVILLOHET PËRMES NJË PROCESI TË BAZUAR NË ANALIZËN E PROFESIONIT DHE PËR TË PLOTËSUAR NEVOJËN E IDENTIFIKUAR TË INDUSTRISË APO SEKTORIT.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

**3. KUALIFIKIMI LIDHET ME NJË "PROFIL" BAZUAR NË KËRKESAT MËSIMORE PËR NJË PROFESION APO GRUP PROFESIONESH, DUKE PËRFSHIRË STANDARDET KOMBËTARE PROFESIONALE PËR PROFESIONIN APO GRUPIN E PROFESIONEVE PËRKATËSE.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

**4. PËRMBAJTJA E KUALIFIKIMIT SHPREHET ME REZULTATE TË MATSHME TË NXËNIT, TË CILAT OFROJNË QËLLIME TË QARTA MËSIMORE DHE DUHET QË NORMALISHT TË PËRSHKRUHEN NË FORMË MODULARE.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

| | |
|---|---|
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

5. **KUALIFIKIMI PËRFSHIN PËRSHKRIMIN E HOLLËSISHËM TË PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË PËRFORMANCËS PRAKTIKE, SË BASHKU ME TË GJITHA DËSHMITË E KËRKUARA.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

6. **KUALIFIKIMI I MUNDËSON KANDIDATËT TË PËRPAROJË DREJT PUNËSIMIT APO MUNDËSI TJERA TË ARSIMIT TË VAZHDUESHËM.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

7. **KUALIFIKIMI ËSHTË I HARTUAR PËR TË MUNDËSUAR PËRPARIM NË KUALIFIKIME TJERA, QOFTË NË FUSHËN E NJËJTË APO FUSHA TË PËRAFËRTA.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

8. **KUALIFIKIMI KA MBËSHTETJEN E AKTERËVE RELEVANT TË ARSIMIT DHE TREGUT TË PUNËS, PËRFSHIRË KAAP.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

**PJESA 4 B:**
**KUALIFIKIMET E AFTËSIMT PROFESIONAL BAZUAR NË STANDARDET PROFESIONALE KOMBËTARE**

**VLERËSIMI I KUALIFIKIMIT KUNDREJT KRITEREVE SPECIFIKE TË VALIDIMIT**

**1. KUALIFIKIMI NDËRLIDHET ME NEVOJËN E IDENTIFIKUAR TË INDUSTRISË APO SEKTORIT.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Kualifikimi ndërlidhet me nevojat e identifikuar të industrisë dhe për tregun e punës, por këto nevoja duhet të jenë me specifike duke analizuar dhe identifikuar sa më shpesh dhe të jepen dëshmi të qarta për analizën.

**2. KUALIFIKIMI ËSHTË I BAZUAR NË STANDARDET PROFESIONALE KOMBËTARE RELEVANTE TË ZHVILLUARA PËRMES ANALIZËS PROFESIONALE DHE DUHET TË JENË TË MIRATUARA NGA KAAP.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Kualifikimi është i bazuar kryesisht në standarde profesionale ndërkombëtare (ECDL).

**3. KUALIFIKIMI LIDHET DREJTPËRDREJTË ME PROFESIONIN APO GRUPIN E PROFESIONEVE TË IDENTIFIKUARA.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | √ |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Në bazë të analizës së klasifikimit të profesioneve, është ardhur në përfundim se ky kualifikim është i lidhur drejtpërdrejt me profesionet e administrimit të biznesit etj. Këto i kanë potencuar edhe kandidatët e pranishëm si dhe trajneri. Megjithatë këto ndërlidhje janë bërë vetëm tek pjesa teorike dhe një ndërlidhje e tillë nuk është realizuar edhe në pjesën praktike. Tek pjesa praktike është me rendësi që të simulohet ambienti ku do të bëhej ndërlidhja.

**1. KUALIFIKIMI PËRBËHET PREJ MODULEVE ME PËRMBAJTJE TË SHPREHURA NË REZULTATE TË MATSHME TË ARRITURAVE TË CILAT OFROJNË QËLLIME TË QARTA MËSIMORE/TRAJNUESE.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | √ |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

- Plan programi i ri është i hartuar në formë modulare dhe ka objektiva të qarta.
- Në çdo modul janë caktuar saktë rezultatet e mësimit, instrumentet e vlerësimit, kriteret e vlerësimit dhe mjetet e realizimit.
- Për secilin modul dihen objektivat dhe qëllimet që duhet të arrijë kandidati.

**4. KUALIFIKIMI PËRFSHIN PËRSHKRIMIN E HOLLËSISHËM TË PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËN PRAKTIKE, SË BASHKU ME SASINË DHE LLOJET E DËSHMIVE TË KËRKUARA.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Dëshmitë e kërkuara për vlerësim të performancës janë ofruar dhe në bazë të analizës konkludohet se këto procedura janë plotësuar kryesisht në përjashtim të pjesës ku kandidati nuk e ka të njohur numrin e pikëve për secilën pyetje. Vlerësimi praktik në krijimin e një produkti final është i kënaqshëm, bazohet në rezultate të cilat krahasohen me standarde.
Rekomandohet të përpilohen testet sipas paketës së re mësimore dhe të shënohen pikët dhe të tregohet saktë përqindja e kalueshmërisë së kandidatit.

**5. KUALIFIKIMI I MUNDËSON KANDIDATIT TË PËRPAROJ DREJT PUNËSIMIT APO MUNDËSI TJERA TË ARSIMIT TË VAZHDUESHËM NË KUADËR TË PUNËSIMIT.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**
Certifikimi është një dëshmi se kandidati është aftësuar dhe është i gatshëm për tu futur në tregun e

| | | |
|---|---|---|
| Pjesërisht plotësohet | | punës. Megjithatë qendra nuk ka ndonjë mekanizëm i cili merr informacione kthyese nga të certifikuarit se a kanë mundur të gjejnë punë apo jo. I vetmi mekanizëm që përdorë qendra është biseda telefonike me kandidatët për ti pyetur ata nëse kanë gjetur punë apo jo. |
| Kryesisht plotësohet | √ | |
| Përmbushet plotësisht | | |

6. **KUALIFIKIMI KA MBËSHTETJEN E AKTERËVE RELEVANT TË ARSIMIT DHE TREGUT TË PUNËS, PËRFSHIRË KAAP.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Kualifikimi e ka mbështetjen nga vet Qendra nga donatorë kombëtarë siç është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Nuk ka ndonjë analizë të saktë, por në bazë të analizave rrethanore konkludohet se shumica nga numri i të certifikuarve kanë arritur të hyjnë në tregun e punës.

## PJESA 4 C:
## KUALIFIKIMET E AFTËSIMIT PROFESIONAL TË BAZUARA NË STANDARDET PROFESIONALE TË CILAT NUK JANË TË MIRATUARA NË NIVEL KOMBËTAR

### VLERËSIMI I KUALIFIKIMIT KUNDREJT KRITEREVE SPECIFIKE TË VALIDIMIT

1. **ZHVILLUESI I KUALIFIKIMEVE DUHET TË OFROJË DËSHMI TË MJAFTUESHME PËR TË DEMONSTRUAR SE KUALIFIMI I PROPOZUAR ËSHTË I BAZUAR NË NEVOJËN REALE TË TREGUT TË PUNËS P.SH. DUKE U NDËRLIDHUR ME NEVOJAT E NDONJË PROFESIONI TË VEÇANTË, APO TË SHKATHTËSIVE DHE NJOHURIVE TË IDENTIFIKUARA GJATË USHTRIMIT TË NDONJË PROFESIONI.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Profil i TI është krijuar duke u bazuar në analizën e tregut të punës dhe nevojat për kualifikim. Megjithatë propozimet duhet të jenë shumë më të ndërlidhura me analizat e QT KEK dhe të jenë të përditësuar së paku në baza vjetore.

2. **KUALIFIKIMI PËRBËHET PREJ MODULEVE ME PËRMBAJTJE TË SHPREHURA NË REZULTATE TË MATSHME TË TË ARRITURAVE TË CILAT OFROJNË QËLLIME TË QARTA MËSIMORE/TRAJNUESE.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

S'ka dyshim se programi i ECDL-se është një standard tanimë i dëshmuar ne Evropë dhe pjesën tjetër te botes (i njohur si ICDL), dhe si i tille qe është shpreh ne mënyrë te balancuar dijen e nxënë ne raport me vlerësimin e te njëjtës. Ne rastin e QT KEK-se, modeomos duhet te kihet parasysh përditësimi i programit te ECDL-se ne versionet me te reja te tije.

3. **KUALIFIKIMI PËRFSHIN PËRSHKRIMIN E HOLLËSISHËM TË PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË PËRFORMANCËS PRAKTIKE, SË BASHKU ME SASINË DHE LLOJET E DËSHMIVE TË KËRKUARA.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Dëshmitë e kërkuara për vlerësim të performancës janë ofruar nga qendra. Në bazë të analizave të dëshmive del se procedurat kryesisht janë plotësuar. Propozohet që plotësimi i dokumentacionit për proceset e punës të standardizohet dhe arkivohen sipas standardeve ISO 9001 2008.

4. **KUALIFIKIMI I MUNDËSON KANDIDATIT TË PËRPAROJ DREJT PUNËSIMIT APO MUNDËSI TJERA TË ARSIMIT TË VAZHDUESHËM NË KUADËR TË PUNËSIMIT.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht | √ |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Ky kualifikim u mundëson kandidatëve që të përparojnë në tregun e punës. Në bazë të informacioneve që i posedon qendra, pjesa dërmuese e kandidatëve të trajnuar në ketë fushë janë punësuar. Qendra nuk ka informacion të saktë për numrin e të punësuarve sepse nuk ekziston ndonjë

| | |
|---|---|
| plotësohet | |
| Përmbushet plotësisht | |

mekanizëm i cili do të tregonte për numrin e saktë të të punësuarve.

**5. KUALIFIKIMI KA MBËSHTETJEN E AKTERËVE RELEVANT TË ARSIMIT DHE TREGUT TË PUNËS.**

| | |
|---|---|
| Nuk plotësohet fare | |
| Pjesërisht plotësohet | |
| Kryesisht plotësohet | √ |
| Përmbushet plotësisht | |

**Arsyet për këtë konkluzion:**

Kualifikimi e ka mbështetjen e plotë si nga ana e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e po ashtu edhe nga MPMS. Megjithatë ka mundësi që të përfshihet me shumë tregu i punës si nga sektori publik ashtu edhe nga ai privat.